

2021

Përmbledhje Jo-Teknike “KEJVI”
shpk

Zhvilluesi: “KEJVI” Shpk

Projekti: "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane"

Shoqëria:

KEJVI sh.p.k

Përgatitur nga:



TETOR, 2021

Përmbajtje

1. HYRJE.....	0
2. KUSHTET EKZISTUESE.....	0
3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT	0
4. TRANSPORTI I BRENDSEHEM DHE NDERLIDHJA	3
5. LENDA E PARE E PERDORUR	4
6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	6
7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME	7
8. MBROJTJA E OBJEKTIT-MASAT NDAJ ZJARRIT	8

1. HYRJE

Shoqëria Kejvi sh.p.k synon zhvillimin e aplikimit për leje mjedisi të tipit B.

Referuar Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe fakti që objekti ku kërkohet të zhvillohet aktiviteti është ekzistues dhe bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, operatori “KEJVI” sh.p.k do të aplikojë pranë QKB-së për pajisjen me leje mjedisore me kodin:

- Industrite energjitike, ID 1.10, “Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane”

2. KUSHTET EKZISTUESE

KEJVI shpk është një shoqëri tregtare e krijuar si person juridik me numer unik identifikimi te subjektit K67723301I, kryesisht në aktivitet:

- Tregetim me pakice te karburantit per automjete.

Në kuadër të këtij aktiviteti Shoqëria KEJVI SHPK kryen aktivitetin e tregtimit te karburantit me pakice per automjete.

Vendndodhja e pikes se karburantit me aktivitet: Veprimtarinë “ID, 1.10, Furnizimi me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant” i cili ndodhet ne adresen Lezhe, Lac, Lagjia 4, Rruga kryesore, ndertesa 1 kateshe, Zona kadastrale nr.2364, me pasuri nr.4/370.

3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

Skema e perpunimit teknologjik te pikes se furnizimit me pakice te karburanteve eshte zgjedhur duke shfrytezuar te dhenat e shoqerise “KEJVI” shpk.

Rezervuari i karburantit te kompanise “KEJVI SHPK” ka kapacitet 60000 litra karburant dhe 5000 litra GLN.

Rezervuari eshte i futur nen toke dhe dy pompat jane jashte.

Përmbledhje Jo-Teknike "KEJVI" shpk

Seicila pompe ka dy pistoleta te kalibruara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise.

Rezervuari ka linje te vecante te ajrimit dhe te furzinimit te tij nga autocisterna.



Tubat e perdorur per keto linja jane prej celiku te zinguar.

Per vete karakterin teknologjik te ketij lloji dhe rrezikshmerine qe paraqesin ato, eshte parashikuar edhe mbrojtja e pajisjeve nga renia nentension dhe nga shkarkimet atmosferike.

Në vijim është pasqyruar material fotografik i aktivitetit.



Në vijim është pasqyruar edhe planimetria e objektit dhe aktivitetit që do synohet të zhvillohet:



Grupi i studimeve dhe projektive teknologjike e konstruktive "ELMACERARO"		PIKE PER SHITJEN ME PAKICE TE KARBURANTEVE Implanti i gazit te lengezuar Lag - Kurbini		Nr. vizatimit 12000
Projekttoi	Fatmir SUKAJ	Nr.Lic.MZ-0775	Faza	Shkalla 1:250
Projektori	Kreshnik STRATI		Projekti zbatimi	Fleta Nr.1
Porositesi	Artur NDOJ		PLANIMETRIA VENDOSJES SE OBJEKTIT	Gjithsej 10
Investitori	Artur NDOJ			Shtator 2010

4. TRANSPORTI I BRENDSEM DHE NDERLIDHJA

Kompozimi i objektit është bërë duke konsideruar fillimisht skemën e lidhjes teknologjike të aparaturave në pikën e furnizimit me karburant, si dhe mundësitë e dhëna nga sheshi i parashikuar.

Mbi këto synime është realizuar shtrija në plan dhe në lartësi të objektit.

Rezervuari i karburantit të shoqërisë "Kejvi shpk" ka kapacitet Gazoil me kapacitet 60000 litra karburant dhe 5000 litra GLN.

Per vete karakterin teknologjik te ketij lloji dhe rrezikshmerine qe paraqesin ato, eshte parashikuar edhe mbrojtja e pajisjeve nga renia nen presion nëpërmjet certifikatës së konformitetit të vërtetimit të përputhshmërisë së projektit teknik të pajisjes/instalimit nën presion.

5. LENDA E PARE E PERDORUR

Gazi i Lëngëzuar i Naftës është term i përgjithshëm që përdoret për përcaktimin e gazeve të kthyer në gjendje të lëngët, të cilat përbëhen kryesisht nga hidrokarbure me 3 apo 4 atome karboni. Këto hidrokarbure janë gaze në temperaturë dhe presion të zakonshëm të ambientit, por që lëngëzohen në kushte të tjera të temperaturës e presionit. Hidrokarburet e mësipërme në fazën e lëngët zënë vetëm 1/250 pjesë të vëllimit që ato zënë duke qenë në fazën e gaztë. Kjo veti e bën praktike depozitimin dhe transportimin e tyre në gjendje të lëngët. Për përdorim të përgjithshëm shfrytëzohen dy lloje gazi të lëngëzuar: butani dhe propani tregtare ose përzierja e tyre. Karakteristikat e këtyre produkteve përcaktohen në kushtet teknike përkatëse. Gazi i lëngëzuar mund të depozitohet në fazën e lëngët ose në temperaturën e ambientit në presion mesatar ose me ftohje në presione më të ulta. Meqenëse temperatura e magazinimit është e ulët deri në vlera të caktuara gazi i lëngëzuar mund të magazinohet në presion atmosferik.

- Instalimi i rezervuarëve të GLN-së

Rezervuari është vendosur mbi tokë me karkas betoni të armuar e mbushur me rërë mbi një pllakë betoni dhe është lidhur fort me katër pika ankorimi.

Rezervuari instalohet sipas udhëzimeve të Urdhërit nr. 184, datë 05.07.2005 i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për kushtet dhe normat e projektimit të impianteve, instalimeve dhe pajisjeve, që shërbejnë për depozitimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre" pjesa e trete, kapitulli II, pika 2.3 rezervaret e fiksuar, dhe udhëzimeve të prodhuesit.

- Aparati i shpërndarjes

Aparati i shpërndarjes është i tipit të miratuara nga organet kompetente (i markuar CE).

Aparati i shpërndarjes është i pajisur me një valvul kundër tërheqjes e vendosur në hyrje të tubit fleksibël të thithje-dhënies.

Aparati i shpërndarjes është i tokëzuar.

- Instalimi i rezervuarëve të benzinës dhe naftës

Rezervuarët e naftës dhe të benzinës janë me llamarinë çeliku dhe të bashkuar me saldim. Rezervuarët janë të pajisur me kapak (bokaport) të mbërthyer me bulona për të lejuar hapjen e tyre për kontroll. Të kapaku i depozitës janë të vendosur shënimet:

1. Prodhuesi
2. Viti i prodhimit
3. Permasat
4. Kapaciteti i rezervuarit

Rezervuarët janë të ljer nga jashtë me material anti-koroziv e hidro-izolues dhe me mbrojtje katodike për tu mbrojtur nga korrozioni nëntokësor. Të gjithë tubacionet dhe lidhjet me rezervuarin janë me tuba të pa oksidueshë. Aksesoret janë të certifikuar CE dhe kanë kaluar me sukses kontrollin e cilësisë. Tapat e hermetizimit të rezervuarit janë prej materiali bronx dhe alumin të markuar Atex për të evituar shkëndijat elektrike dhe për të evituar korrozionin. Tapat janë me filetimit konik dhe janë për lidhje të shpejt me rezervuarin.

Rezervuarët janë vendosur nëntokë në mënyrë të tillë që pika më e lartë e boka-portës është 0.5 m nën kuotën mbi rezervuar.

Rezervuarët janë brenda një konstruksioni prej betoni në formë karkase të hapur dhe të mbuluar me rërë deri në nivelin e tokës.

Rezervuarët kanë tuba ajrimi me koka të pajisura me rrjetë teli si filtër e të kthyer poshtë me diametër $\frac{3}{4}$ " dhe janë të sistemuar në një pikë larg vatrave të zjarrit që ndodhet në lartësinë 3m nga niveli i tokës. Tubat e ajrimit kanë dhe pajisje të veçanta që bëjnë shmangien e shkarkimeve të avujve në atmosfere dhe tërheqjen e tyre nga autoçisternë e cila e kthen në vende të veçantë. Rezervuarët janë tokëzuar para ljerjes së tyre.

Rezervuarët para përdorimit duhet të bëjnë provën e hermeticitetit nën përgjegjësinë e përdoruesit të tyre.

Mbushja maksimale e çdo rezervuari bëhet në vlerën:

- a) Për benzinën: deri në 90 % të volumit
- b) Për gazoilin: deri në 95 % të volumit

Skema teknologjike e furnizimit të rezervuarëve të produkteve të naftës dhe benzinës, është zgjedhur e tillë që siguron furnizimin e tyre me cikël të hapur dhe cikël të mbyllur. Mënyra e furnizimit me cikël të mbyllur ka epërsinë se eviton daljen e avujve të produktit të naftës që furnizohet në mjedis, megjithatë ajo mbetet e varur nga tipi i autoçisternës që përdoret.

6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Përshkrimi i shkurtër i zonës

Objekti është i vendosur në një zonë të banuar.

Zhvillimi i aktivitetit të KEJVI Shpk, nuk konsiderohet si aktivitet me ndikime në zonën përreth.

Airi

Aktiviteti i subjektit është vetëm furnizimi me pakice për automjete me karburant dhe për këtë arsye nuk ka shkarkim të ndotësve në ajër. Ndotja në ajër konsiderohet e papërfillshme, tepër minimale dhe e kufizuar në kohë pasi sistemi i instalimit dhe teknologjia e përzgjedhur minimizon në maksimum emetimin e aromave dhe rrjedhjet e gazeve në atmosferë.

Ujërat

Në përgjithësi nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit nuk ka shkarkime ujore apo ndotje pasi aktiviteti është i kufizuar. Në rast derdhesh aksidentale të hidrokarbureve në sipërfaqe, përsëri nuk parashikohet ndotje pasi sipërfaqja është e shtruar me beton dhe si rrjedhojë është i pamundur infiltrimi i hidrokarbureve në ujërat nëntokësore. Ndotja e ujit konsiderohet e papërfillshme.

Zhurmat

Aktiviteti i punës është i tillë që nuk ka burime fikse të zhurmës, duke qenë se procesi i punës përfshin vetëm furnizimin. Gjithsesi si impakt zhurma mund të vije nga levizja e mjeteve.

Flora dhe fauna

Nuk parashikohen ndikime në bimësi duke përmendur lloje endemike, lloje me status të veçantë, habitate me vlera, ekosisteme funksionale etj. Zona nuk ka vlera të veçanta floristike, megjithatë zona e subjektit për ushtrimin e aktivitetit është e kufizuar në një sipërfaqe jo të madhe. Gjithashtu edhe për faunën e zonës, lidhur me specie me status të veçantë dhe të mbrojtura, theksohet se specie të tilla nuk janë prezente në zonën e aktivitetit. Përreth zonës mund të hasen vetëm shpende të qytetit.

Ndotja e tokës

Zhvillimi i aktivitetit të synuar nuk shkakton shkarkime në toke dhe si rrjedhim nuk ndikon në cilësinë e tokës apo shkakton ndotje të saj. Mbetjet e gjeneruara gjatë ditës së punës grumbullohen në koshat përkatës nga punonjësit e karburantit dhe më pas largohen për në vendndodhjen e grumbullimit të mbetjeve nga njesia lokale. Nuk parashikohen ndikime negative në tokë nga ushtrimi i aktivitetit.

Rastet aksidentale

Zbatimi i aktivitetit të subjektit vlerësohet se nuk do të sjell rrezikshmëri për aksidente. Në rast zjarri automjetet zjarrfikëse mund të afrohen dhe të veprojnë për shuarjen e tij pa pengesë dhe në mënyrë efektive. Objekti plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe urbanistike për të kryer një aktivitet të tillë. Gjithashtu mbajtja e fikësve të zjarrit në objekt është e nevojshme, në rastet e ndërhyrjes ndaj zjarrit. Janë marrë masat për parandalimin e rasteve aksidentale, mjetet kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikanti apo karburant. Shoqëria siguron se do ketë ndërhyrje të menjëhershme nëse do të ketë ndikime negative në mjedis.

Burimet e shkarkimeve nga instalimi

Nga aktiviteti i furnizimit me karburant nuk ka burime emetimi, pasi nafta në territorin e karburantit, vjen e mbyllur dhe e izoluar. Parashikohet që gjatë transportit të cisternes me naftë, nga makineritë e transportit të këtyre emetimeve të lehta (pluhura, gaze), si dhe gjenerim të vogël të zhurmave.

Monumente, trashëgimi, vepra

Nuk ka vlerë trashëgimore zona e ushtrimit të aktivitetit. Lidhur me peisazhin, inxhinieret janë kujdesur gjatë fazës së projektimit për anën estetike të projektit dhe hapësira të gjelbëruara.

7. TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

- Shoqëria KEJVI Shpk, zbaton teknikat më të mira të disponueshme për të minimizuar ndotjet. Duke patur parasysh aktivitetin e kompanisë, përmendim këtu: kontrollin periodik dhe inspektimin për incidente të mundshme gjatë transportit apo magazinimit të naftës, spërkatjen me ujë të territorit përreth cisternes në kohe të thate, uljen e shpejtësisë së makinerive, trajnimin e punonjësve etj.

- Marrjen e menjëhershme të masave në rast ndotjesh (incidente me derdhjet e karburanteve, vajrat nga makinerite) si dhe monitorim të vazhdueshëm.
- Në përputhje me ligjin e intergruar të mbetjeve, kompania ka parim minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe në fund asgjësimin e tyre.
- Kompania ka marrë masa për të parandaluar incidentet: fikja e makinerive/pajisjeve kur nuk është e nevojshme që të punojnë, shfrytëzimi i dritës natyrore.
- Subjekti synon kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike të makinerive, duke minimizuar kështu avaritë dhe ndotjet që mund të vijnë si pasojë. Gjithashtu subjekti do të pajisë ambientet me kutine përthithese (spill-kit) në rast incidenti për të parandaluar incidentet me karburant si dhe ka bërë trajnimin e duhur të punonjësve në lidhje me nderhyrjen dhe përdorimin e kutisë së incidenteve.
- Paralelisht me funksionimin, subjekti gjithashtu do të kujdeset dhe për rehabilitimin e mjedisit, në mënyrë që të minimizohet impakti negativ fillestar në peisazh. Subjekti mer për parasysh sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

8. MBROJTJA E OBJEKTIT-MASAT NDAJ ZJARRIT

Për vetë karakteristikat e punës së objektit do të përdoren lëndë lehtësisht të ndezshme. Janë parashikuar të merren një sërë masash teknike dhe administrative për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e punës në objekt.

Për vendosjen e depozitës plotësohen të gjitha kërkesat teknike të rregullores së instalimit të pajisjeve të gazit. Distanca të sigurojë respektojnë kërkesat e Urdhërit nr. 184, datë 05.07.2005 i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për kushtet dhe normat e projektimit të impianteve, instalimeve dhe pajisjeve, që shërbejnë për depozitimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre" pjesa e tretë, kapitulli II.

Gazi i lëngshëm i naftës nuk përbën impakt për ambientin dhe ekosistemin. Megjithatë për vetë kushtet e punës së tij si lëng nën presion, aparatat dhe pajisjet janë të tilla që nuk lejojnë asnjë rrjedhje. Përveç kësaj rezervuarve u janë vendosur valvula fluksi dhe kundervalvula në të gjitha konjeksionet e tij, me qëllim bllokimin e menjëhershëm të rezervuarit për çdo rast të konstatimit të rrjedhjeve në tubacione dhe pajisje.

Pajisjet që shërbejnë në përdorimin e GLN, si dhe materialet që përdoren paraqesin një sërë rreziqesh për personelin që punon. Këto rreziqe do të njihen dhe të kontrollohen me qëllim që

të bëhen të padëmshme, në një nivel të pranueshëm, të përcaktuar nga rregullorja e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

Masat për ruajtjen dhe sigurinë në punë përcaktohen nga studimi dhe njohja e procesit të punës si dhe nga njohja e karakteristikave të pajisjeve që do të përdoren. Për këtë qëllim Administratori do të hartojë "Rregulloren e shfrytëzimit" dhe "Rregulloren e Sigurisë dhe mbrojtjes në punë në impiante".

Materialet më të dhëna për përdorimin e sigurtë duhet të afishohen në mënyre që të lexohen nga të gjithë.